



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË-MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY  
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE

Agjencia për Pronësi Industriale – Agjencia za Industrijsku Svojinu -  
Industrial Property Agency

# **R A P O R T V J E T O R**

## **2 0 1 8**

Adresa: Rr. “Muharrem Fejza” p.n., Lagjja e Spitalit 10000 Prishtinë/Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 200 36 554  
Web: [www.kipa.rks-gov.net](http://www.kipa.rks-gov.net)

## 1. Pranimi i shkresave/aplikimeve


Agjencia e Pronësisë Industriale ka vazhduar aktivitetin e saj në pranimin dhe evidentimin e aplikimeve për objekteve të pronësisë industriale: Marka Tregtare; Patenta; Dizajn Industriale; kundërshtime të markave të publikuara; hulumtime të markave tregtare; patentave; ekzaminime të parakohshme; vazhdime; ndryshime; kërkesa për mbajtje në fuqi; dokumente të përparësisë; ndërrim përfaqësuesi; autorizime gjeneralë; autorizime për lëndë përkatëse; ankesa në komision të ankesave; vendime të komisionit të ankesave dhe dokumentacione tjera shtesë.

Gjithsejtë gjatë kësaj periudhe kohore, janë pranuar në zyrën e pranimin të dokumentacionit të API-së **9782** shkresa të ndryshme, të cilat i kemi pasqyruar në tabelën e mëposhtme. Gjatë këtij viti kemi pasur shtim të numrit të dokumenteve hyrëse, që vërehet dhe nga grafiku i mëposhtëm. Ky shtim ka ndodhur për shkakun e vazhdimin të markave tregtare të vitit 2008, që korrespondon me 10 vjetorin e aplikimit.

Marka Tregtare aplikime	<b>1716</b>
Patenta aplikime	<b>21</b>
Dizajn industriale aplikime	<b>15</b>
Kërkesa për vazhdime të markave tregtare	<b>3254</b>
Kërkesa për ndryshime në regjistër të markave tregtare, patentave dhe dizajnëve industriale	<b>1309</b>
Kërkesa për plotësime të Markave Tregtare, taksa për lëshimin e vendimit dhe taksa për lëshimin e certifikatës për Marka Tregtare, pagesa të patentave	<b>1761</b>
Kërkesa për kufizimin e listës së produkteve	<b>11</b>
Kërkesa për ekzaminimin e parakohshëm të Markave Tregtare	<b>3</b>
Autorizime	<b>168</b>
Kërkesa për mbajtje në fuqi të patentave	<b>419</b>
Kundërshtime të Markave Tregtare	<b>80</b>
Kërkesa për zgjatje afati	<b>7</b>
Kërkesa për heqje dorë të Markave Tregtare dhe Patentave	<b>20</b>
Kërkesa për korrigjimin e vendimeve dhe aplikimeve	<b>411</b>
Kërkesa për ekstrakt regjistri	<b>30</b>
Kërkesa për tërheqje të kundërshtimit	<b>4</b>
Dokumente prioriteti	<b>69</b>
Kërkesa për informacione të Markave Tregtare dhe Patentave	<b>50</b>
Mirëmbajtje vjetore të licencës së përfaqësuesve	<b>28</b>
Ankesa kundër vendimeve të API-së	<b>49</b>
Kërkesa për shfuqizimin e vendimeve	<b>6</b>
Vendim i komisionit të ankesave	<b>9</b>
Kërkesa për vazhdimin e dizajnit industrial	<b>12</b>

Përgjigje në kundërshtimin e Markave Tregtare	88
Kërkesa nga palët	242

Tabela 1. Statistika e shkresave të pranuar në API, Janar-Dhjetor 2018




## 2. Ekzaminimi i Aplikimeve / shqyrtimi i shkresave

### Patenta

Numri i aplikimeve të patentave ka rënë gradualisht në vite, kjo për shkakun e mos anëtarimit të Kosovës në EPO, dhe industrisë jo të zhvilluar kopjuese të tregut të Kosovës. Aplikuesit e patentave me rastin e aplikimit në shtete të caktuara, shikojnë së pari interesin e shitjes së patentës së tyre, dhe zhvillimin e industrisë së atij vendi. Me rastin e anëtarimit të Kosovës në Zyrën Europiane të Patentave, pritet të shtohen aplikimet e patentave, pasi aplikuesit i kushton më lirë mbrojtja përmes EPO, duke krahasuar me mbrojtjen nacionale që aplikohet tashmë në Kosovë.

Backlog tek patentat nuk egziston, pasi janë të përfunduara **98.06%** të aplikimeve. Pjesa tjetër ekzaminohen me kohë pas kalimit të periudhës 18 mujore, që është standard ndërkombëtar i kohës së qëndrimit të aplikimit pa u publikuar.



Njoftim për plotësimin e aplikacioneve për patentë	<b>17</b>
Njoftim për pagesën e tarifave për lëshimin e vendimit për njohje	<b>24</b>
Vendim për njohjen e patentës	<b>27</b>
Vendim të tërësishme – pjesërisht të patentave	<b>7</b>
Vendim për ndryshim të aplikacioneve-vendimeve të patentave (emrit, pronarit, adresës)	<b>11</b>
Vendim për refuzimin e aplikacioneve për patentë	<b>24</b>
Hapa në sistemin IPAS	<b>5118</b>
User doc acceptance, pranimi i mbajtjeve në fuqi pas kontrollimit, dhe i dokumenteve tjera përcjellëse të hyra si user dokumente për aplikimet dhe regjistrin e patentave	<b>473</b>
Mbatje në fuqi të kontrolluara dhe chekuara	<b>428</b>

*Tabela 2. Statistika vjetore të sektorit të patentave 2018*

### Marka Tregtare:

Numri i aplikimeve të markave tregtare ka shënuar rritje në vitin 2018 për **8.95%**, krahasuar me vitin paraprak. Rritja e numrit të aplikimeve sidomos e atyre vendore i atribuohet dhe aktiviteteve të realizuar nga API për ngritjen e vetëdijes mbi rëndësinë e mbrojtjes së produkteve dhe shërbimeve me markë tregtare, si seminare, konferenca dhe promovim në media, të mbajtura gjatë këtij viti kalendarik.

Sa i përket back log të markave tregtare, API gjatë 2018 ka shënuar progres në reduktimin e back log, nga **86.52%** të kryera në vitin 2017, është arritur në **91.59%** në vitin 2018, kjo përkundër pranimit të mbi 1716 aplikimeve të reja për marka tregtare.

Për zgjidhjen e 1600 aplikimeve të reja, API duhet të zhvillojë 9600 procedura, që përfshijnë, 1600 ekzaminime formale, 1600 ekzaminime absolute, 1600 publikime, 1600 ftesa për regjistrimin e MT, 1600 vendime dhe 1600 certifikata.

Për kryerjen dhe përfundimin e back log, si dhe vazhdimin normal të procedimit të lëndëve, API ka dorëzuar propozimet e saj për strukturën e re organizative së bashku me arsyetimet e pozitave të kërkuara, ku janë të specifikuar dhe numri i ekzaminimit për zyrtar. Sipas normave ndërkombëtare, një ekzaminues mund të kryej deri në 400 ekzaminime të MT në vit, deri në regjistrimin e tyre, ndërsa API në gjysmën e 2 të vitit 2018 ka vepruar me vetëm 1 ekzaminues për marka tregtare.

Gjatë vitit 2018 API ka ndarë një buxhet shtesë për rekrutimin e stafit teknik për përgatitjen e vendimeve, certifikatave, ftesave dhe mirëmbajtjen e skanimit të dokumenteve hyrëse dhe dalëse.




Tabela punuese e markave tregtare gjatë vitit 2018.

Vendime për regjistrimin e markave tregtare	<b>2117</b>
Publikime të markave tregtare pas ekzaminimit	<b>1918</b>
Njoftime për plotësimin e aplikacioneve	<b>149</b>
Njoftime për heqje dorë të markave tregtare	<b>116</b>
Vendime për ndryshimin në regjistër të markave tregtare	<b>1222</b>
Vendime për vazhdimin e markave tregtare	<b>1840</b>
Lëshimi i certifikatave për marka tregtare	<b>2308</b>
Ftesë për përgjigje në kundërshtimin e markës tregtare	<b>130</b>
Ftesë për pagesën e vendimit për markë tregtare	<b>1686</b>
Ekstrakte regjistri	<b>32</b>
Vendime për refuzimin e MT	<b>414</b>


Tabela 3. Statistika vjetore të sektorit të markave tregtare gjeneruar përmes IPAS

## Dizajni Industrial

Numri i aplikimeve të dizajnit industrial qëndron relativisht i njëjtë. Si tek patentat dhe tek dizajni industrial numri i aplikimeve nuk është i knaqshëm, jo për shkakun e zhvillimit industriale dhe produkteve të reja në Kosovë. Me dizajn industrial mbrohet dukja e jashtme e produktit, dhe duhet njiashu që produkti të ketë karakter individual, dmth të jetë një lloj risie në fushën përkatëse.

Gjatë vitit 2018 API ka rekrutuar zyrtaren përkatëse për shqyrtimin e dizajnëve industriale. Në muajin Nëntor është organizuar trajnimi mbi shqyrtimin e dizajnit industriale për zyrtaren përkatëse. Ky trajnim është mbështetur nga projekti i EU “ Mbështetja e Tregtisë në Kosovës”, ku API është pjesë e komponentës së 4 të projektit.

Gjatë 2018 janë shqyrtuar 75 aplikime të dizajnëve industriale. parashihet që të përfundohet me shqyrtimin e tyre në kuartalin e 2 të vitit 2019



## Përmbledhje e tabelave punuese

Nga të dhënat statistikore të nxjerra në sistemin IPAS del se zyrtarët e API-së gjatë vitit 2018 kanë kryer gjithsejti **35399** hapa në sistem, hapat përfshijnë kalimin nga një procedurë e ekzaminimit në procedurën tjetër.

Janë printuar **11411** dokumente dalëse, vendime, certifikata, ftesa, për përfundimin e proceseve të shqyrtimit të aplikimeve.

Gjatë këtij viti janë skanuar, indeksuar dhe dërguar në server, **19445** shkresa hyrëse dhe dalëse, që e bën procesin e pranimit dhe lëshimit të dokumenteve të elektornizuar.

### **3. Kundërshtimet e regjistrimit të markës tregtare dhe kërkesat për deklaram të shfuqizimit**

Këtë vit, përveç veprimeve esenciale, që janë lëshimi i 130 ftesave për përgjigje në kundërshtimin e MT, nuk janë ekzaminuar kërkesat për kundërshtim të regjistrimit të markës tregtare dhe kërkesat për deklaram të shfuqizimit. Është e domosdoshme që të pranohet dhe miratohet propozimi për ri-strukturimin e API-së, ku do të kishte sektor të veçantë të cilët merren me shqyrtimin e tyre. Deri më tani janë pranuar **486** kundërshtime të markave tregtare dhe **33** kërkesa për shfuqizimin e markave tregtare të regjistruara.

Sipas raportit të bërë nga projekti i kaluar i EU, 1 ekzaminues apo ekspert, mund të kryej deri në 66 kundërshtime në bazë vjetore (raporti Mr. Hallgren datë 01/11/2014). Në API ekzaminuesit e tashëm janë të dedikuar për ekzaminimin e aplikimeve të reja. Miratimi i rregullores së propozuar do të krijonte bazën e shëndoshë për shqyrtimin e tyre.

### **4. Treguesit gjeografik dhe topografëve të integruara të qarqeve**

Është miratuar Udhëzimi Administrativ nr. 09-2018 për Përcaktimin e Simboleve për Treguesit Gjeografikë, Emërtimit të Origjinës dhe Specialitetit Tradicional të Garantuar.

Janë organizuar disa aktivitete në fushën e treguesve gjeografikë, mbështetur nga projektet e EU dhe Ambasada Franceze:

- Është mbajtur tryeza me temën “Treguesi Gjeografikë – Djathi i Sharrit”, ku pjesëmarrës ishin institucionet ndërlidhëse dhe përfaqësuesit e shoqatës së prodhuesve të Djathit të Sharrit.
- Seminari për finalizimin e Specifikacionit të Djathit të Sharrit, si produkt potencial për tu mbrojtur si tregues gjeografikë në Kosovë, seminari është mbështetur nga TAIEX.
- Me mbështetjen e projektit të EU, në Kosovë ka qëndruar në API ekspertja e fushës së treguesve gjeografikë, znj. Ester Olivas Caceres, ku ka analizuar dhe ka përgatitur rekomandimet mbi fushën e treguesve gjeografikë.

Me gjithë këto aktivitete të organizuara dhe kontakte me prodhuesit e djathit të Sharrit, si produkt potencial për tu mbrojtur me tregues gjeografikë, ende API nuk ka pranuar asnjë aplikacion për regjistrimin e treguesit gjeografikë.

## 5. Publikimi i Buletinit të API

Agjencia e Pronësisë Industriale gjatë këtij viti ka publikuar **8** Buletine të Pronësisë Industriale me **6047** objekte të pronësisë industriale të cilat përfshijnë: aplikime të markave tregtare, vendime për regjistrimin e markave tregtare, ndryshimet në regjistër dhe vazhdimet e markave tregtare. Agjencia ka në web faqen e saj dhe regjistrin ku publiku mundë të kërkoj për objekte të pronësisë industriale. Këto shërbime bëjnë API një institucion transparent dhe në linjë me zyrat e tjera rajonale dhe ndërkombëtare

## 6. Digjitalizimi i API-së, Sistemi IPAS, WipoScan, WipoPublish dhe web faqe

Është përfunduar skanimi- ri arkivimi i 26000 aplikimeve të markave tregtare, ky skanim është kryer përmes procesit tenderuar, ku punën e ka kryer kompani kontraktuese.



API është në fazën finale të instalimit të versionit të ri të WipoPublish, që do të realizohet gjatë vitit 2019. Ky version përmirëson qasjen e palëve në kërkimin për objekte të pronësisë industriale, dhe jep një pasqyrë më të saktë të kërkimit.

API gjatë vitit 2018 ka publikuar aktivitetet kryesore në web faqen e saj, janë krijuar 22 lajme dhe publikuar në web faqen [www.kipa.rks-gov.net](http://www.kipa.rks-gov.net)



## 7. Seminare & Aktivitete

- Aktivitetet e API-së përfshinë takimet e zakonshme për raportimin e realizimit të programit të MSA, takimi i nën komiteteve ekzekutive. API raporton në 2 komisione: Nen-komiteti për Tregun e brendshëm, konkurrencën dhe mbrojtjen e konsumatorit, dhe Nen-komiteti për Bujqësi dhe Peshkatari
- Është miratuar mandati i ri i Këshillit Shtetëror për Pronësi Intelektuale. Mandati është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ky mandat i ri ka forcuar rolin e Këshillit si trup koordinues në mes institucioneve të pronësisë intelektuale në Kosovë.
- Është përgatitur pjesa e Strategjisë së Pronësisë Industriale, si pjesë e Strategjisë së sektorit privat 2019-2023. Është përgatitur plani narrativ dhe plani i veprimit të strategjisë së pronësisë industriale.
- Është përgatitur struktura organizative e Agjencisë për Pronësi Industriale, me detyrat dhe përgjegjësitë për secilën pozitë të propozuar. Struktura është pjesë e Draft Rregullores së Brendshme të MTI-së.
- Mbajtja e tryezës me temën “Treguesi Gjeografikë – Djathi i Sharrit”, ku pjesëmarrës ishin institucionet ndërlidhëse dhe përfaqësuesit e shoqatës së prodhuesve të Djathit të Sharrit. Tryeza kishte karakter koordinues në identifikimin e të arriturave dhe ngecjet në fushën e treguesit gjeografikë. Tryeza nxori konkluzione konkret për hapat e mëtejshëm institucional dhe të bizneseve të interesuara për mbrojtje me tregues gjeografikë.



- Promovimi i Pronësisë Industriale media, Radio Kosova dhe Ekonomia Online. Radio Kosova ka realizuar 2 dokumentarë, njëri për marka tregtare dhe për patenta.

- Takim ndërmjet Agjencisë së Pronësisë Industriale dhe Entit Shtetror për Pronësi Industriale të Republikës së Maqedonisë. Ky takim ndodhi si pjesë e bashkëpunimit, i formalizuar dhe me marëveshjen 2 palëshe për bashkëpunim. U darkordua për bashkëpunimin e mëtutjeshëm dhe mbështetjen e Entit Shtetror në lobimin për anëtarësimin e API-së në institucionet ndërkombëtare të pronësisë intelektuale.



- Përgatitja e raportit mbi zbatimin e ligjeve që rregullojnë fushën e pronësisë industriale për të cilat API është përgjegjëse. Ky raport ka identifikuar ngeçjet konkrete në zbatimin e obligimeve që dalin nga ligjet që e rregullojnë fushën e pronësisë industriale.
- U shënuar Dita Botërore e Pronësisë Intelektuale, ku u organizuar Konferenca Kombëtare “Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale”. Pjesëmarrës ishin institucionet ndërlidhëse të pronësisë intelektuale, përfaqësuesit e bizneseve dhe të ftuarit e tjerë. Konferenca ka karakter ceremonial dhe informues mbi të arriturat dhe sfidat e institucioneve ndërlidhëse të pronësisë intelektuale në Kosovë.



- Është mbajtur seminari mbi të drejtat e pronësisë intelektuale në Innovation Center Kosova, ku API ligjëroi mbi pronësinë industriale, dhe rëndësinë e mbrojtjes së produkteve dhe proceseve me markë tregtare, patentë dhe dizajn industrial.



- API së bashku me institucionet e tjera ndërlidhëse të pronësisë intelektuale vizituan panairin “PRISHTINA 2018”, ku u shpërndanë broshura për objektet e pronësisë industriale, specifikiisht mbi mbrojtjen e markave tregtare. Ky lloj aktiviteti ishte i një rëndësie të veçantë pasi API kontaktoi “face to face” me bizneset dhe i inkurajoi ato për ti mbrojtur produktet e tyre, markat e tyre tregtare.



- Aktivitet në Fakultetin Juridik, ku para studentëve u ligjëruea mbi të drejtat e pronësisë intelektuale, mbrojtjen dhe zbatimin e tyre në Kosovë.



- Është përfunduar draftimi i UA “Për përcaktimin e shenjës së treguesit gjeografik të regjistruar”
- Është mbajtur takimi me përfaqësuesit e Projektit të Binjakëzimit, qëllimi i përgjithshëm i këtij Projekti të Binjakëzimit është mbështetja për administratën e Kosovës në menaxhim efikas të procesit të MSA-së. Gjatë takimit është diskutuar plani i veprimit për realizimin e aktiviteteve të paraqitura nga projekti.
- Takimet e Këshillit Shtetëror për Pronësi Intelektuale.



- Më datë 18/09/2018, është mbajtur takimi në mes të përfaqësuesve të Agjencisë për Pronësi Industriale dhe Odës së Afarizmit të Kosovës.



- Agjencia është duke u mbështetur nga një numër i projekteve të EU, të cilat janë duke u realizuar dhe do të realizohen në të ardhmen. API ka mbajtur takim me team liderin e projektit “Mbështetja e mëtejshme për tregtinë në Kosovë”, në takim është diskutuar mbi përgatitjet për fillimin e realizimit të aktiviteteve të përcaktuara në planin e projektit. Projekti do të mbështetë API në disa fusha si ajo legjislative, ngritja e kapaciteteve administrative të API-së, mbështetje për realizimin e marrëveshjeve ndërkombëtare me institucionet e EU në fushën e PI, si EPO apo EUIPO, dhe realizimin e aktiviteteve vetëdijësuese mbi rëndësinë e mbrojtjes së produkteve me pronësi industriale.
- Takim me misionin e WIPO-s mbi sistemin IPAS. Takime me menaxherin rajonal mbi sistemin Adel Bouchee, dhe ekspertin rajonale znj. Hajdari, e cila është ka qenë e angazhuar mbi ndërhyrjet në sistemin IPAS në Kosovë. Mr. Bouchee u nda shumë i kënaqur me gjendjen e sistemit elektronik IPAS, dhe strukturimin e tij, dhe u zotua në ndihmë të vazhdueshme për API-së. API ka sistemin menaxherial IPAS i cili ka 3 komponente, IpasMenager, IpasPublish, IpasPublish, të cilat janë të instaluar dhe shfrytëzohen nga zyrtarët e API-së, pra puna e API-së është proces i digjitalizuar

- Takim me atasheun e Ambasadës Franceze, Joseph GIUSTINIANI. Në takim u diskutuan çështjet në lidhje me treguesit gjeografikë, specifikisht përgatitjet për ardhjen e misionit të ri të Taix.



- Me mbështetjen e projektit të EU, në Kosovë ka qëndruar në API ekspertja e fushës së treguesve gjeografikë, znj. Ester Olivas Caceres, ku ka analizuar dhe ka përgatitur rekomandimet mbi fushën e treguesve gjeografikë. Është draftuar rregullorja e brendshme e punës së komisionit të ekspertëve për produktet bujqësore dhe artikujt ushqimor.



- Seminari për finalizimin e specifikacionit të Djathit të Sharrit, si produkt potencial për tu mbrojtur si tregues gjeografikë në Kosovë



- Është mbajtur seminari mbi shqyrtimin e Dizajnit Industrial. Seminari u mbajt për 2 ditë pune, ndërsa pjesa tjetër është mbajtur trajnimi me zyrtaren e angazhuar për ekzaminimin e dizajnit industrial, ku janë shqyrtuar aplikimet për dizajnin industrial.



- API ka marrë pjesë në 2 konferenca të organizuara nga EPO, “Patenting Blockchain” dhe “Computer Implemented Invention”
- Seminar të organizuar nga WIPO lidhur me aplikimin ndërkombëtar të patentave, PCT

- Pjesmarrje në shënimin e përvjetorit të Drejtorisë së Pronësisë Industriale – Republika e Shqipërisë
- Pjesmarrje në shënimin e përvjetorit të Entit Shtetëror për Pronësi Industriale – Republika e Maqedonisë



- Trajnim për Pronësinë Industriale për zyrtarët e API-së, të organizuar nga Enti Shtetëror për Pronësi Industriale – Republika e Maqedonisë. Në këtë trajnim morën pjesën 3 zyrtarë të API-së.



## 8. Të hyrat financiare

Agjencia realizon të hyra të cilat gjatë kësaj periudhe raportuese kanë qenë në shumën **589,911.00** euro. Për realizimin e këtyre të hyrave janë gjeneruar 9034 fletëpagesa. API ka sistemin e saj online të gjenerimit të fletëpagesave përmes web faqes së saj, ky shërbim i filluar në vitin 2018 ka mundësuar zvogëlimin e kohës për aplikimin dhe qasje në shërbimet e API-së

